



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 422/2 prot.

Tiranë, më 3.03.2021

VENDIM

Nr. 16, datë 5.03.2021

PËR
KORRIGJIM NË VENDIMIN NR. 9 DATË 02.03.2021 TË KOMISIONERIT
PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE

Në mbështetje të neneve 29 dhe 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe të nenit 112 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

KONSTATOVA SE:

Në Vendimin nr. 9 datë 02.03.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konkretisht në pikën 2, të faqes shtatë, konstatova një gabim material i cili korrigjohet si vijon:

“Dënimin e titullarit të Autoritetit Publik znj. Jetmira Bebeçi, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 1 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 112 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

VENDOSA:

1. Korrigjimin e Vendimit nr. 9 datë 02.03.2021, vetëm për sa i përket pikës 2 të faqes shtatë.

2. Kthimin e Vendimit i cili i nënshtrohet korrigjimit, nga pala së cilës i është vendosur në dispozicion.
3. Ky vendim u shpall sot datë 05.03.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

